



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 14 dhjetor 2011, në orën 10:00 sala C-203
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm, Hajredin Kuqi zëvendëskryeministër dhe ministër MD dhe Nenad Rashiq, ministër MPMS.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatore, KIPRED (staf mbështetës) – Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 30.11.2011.
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,
5. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 30.11.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,

Kryetari – *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*, për këtë ministri është për faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse është jo i plotë dhe i pasaktë.

Gjendja e rekomandimeve nga viti i kaluar: Janë dhënë 7 rekomandime prej të cilave asnjë nuk është adresuar plotësisht. Pasuritë jo-financiare nuk janë shpalosur si duhet. Vlerat e prezantuara janë të paqarta dhe të pasakta. Të hyrat vetjake dhe donacionet nuk janë përdorur në pajtim me memorandumin e mirëkuptimit. *Blerjet përmes prokurimit: Aktivitetet e prokurimit pa tri oferta të përgjegjshme.* Janë tri raste që kanë të bëjnë me nevojat e Shërbimit Korrektues të Kosovës: furnizimi me artikuj ushqimor në vlerë prej 679.981 euro, furnizim me pemë dhe perime në vlerë prej 177.365euro dhe furnizim me automjete për transportin e të burgosurve në vlerë prej 111.360 euro.

Mos njoftimi i APP-së për aktivitetet e prokurimit që nuk ishin parashikuar me planin përfundimtar të prokurimit. MD ka nënshkruar kontratë mbi shumën e zotuar të mjeteve. (janë zotuar 50.000euro, ndërsa MD ka lidhur kontratë me fituesin në vlerë prej 59.000euro). MD ka aplikuar normë të ndëshkimit 10 herë me të ulët se sa janë kërkesat ligjore dhe ka bërë llogaritje jo të saktë te ditëve në vonesë në realizimin e punimeve. Certifikimi i lëndëve të pakompletuara dhe jashtë kushteve të kontratës. Pagesat janë bërë pa përfunduar punët dhe atë në shuma të mëdha. Shpenzimet e telefonisë fikse janë tejkaluar në vlerë prej 9.740euro. MD ka bërë rekrutim të stafit dhe avancim të stafit pa respektuar kriteret e kërkuara me ligj dhe Udhëzime. *Pasuritë dhe borxhet:* menaxhim joefikas i pasurive. MD ka blerë programe kompjuterike, të cilat nuk janë vene ne funksion. 540.480euro janë obligime ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 të bartura për pagesë në vitin 2011. *Kontrolli dhe menaxhimi;* ka ndarje jo të mirë të detyrave: një zyrtar kryen tri funksione e që përbënë konflikt interesi. Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të NJAB është e ulët. Komiteti i auditimit edhe pse i themeluar dy here nuk ka organizuar asnjë takim deri në fund të vitit. Kërkoj sqarim lidhur me këto të gjetura. Hap diskutimin.

Murselj Haljilji – Pati dy pyetje për ZAP-in – a ka pyetur auditori se pse norma e ndëshkimit është paraparë 10 herë më e ulët? A kanë pyetur se pse ka ndodhur kjo? Tejkalmi i shpenzimeve të telefonisë fikse është mjaft i lartë dhe pyetja është a ka vërtetuar ZAP se pse ka ardhur deri te kjo? Apo me çfarë të drejte? Janë blerë programe kompjuterike të cilat nuk janë vënë në funksion në vitin 2010. Arsyeja pse nuk janë përdorur dhe pse janë ngutur për blerje nëse nuk kane qenë të nevojshme? A ka ndërmarrë diçka ZAP lidhur me këtë?

Ramiz Lladrovci – Përgëzoi zëvendëskryeministrin për punën që po bënë në MD. Periudha e auditimit sigurisht që nuk i referohet ministrit aktual, por ministri duhet të reflektoi në rekomandimet e auditorit dhe të marr masa për të gjeturat e tij. Komisioni bënë një lloj “ballafaqimi” sepse shumë herë OB nuk pajtohen me të gjeturat e ZAP-it. Inkurajoj ministrin që të kërkoj nga personat e autorizuar që të përmirësojnë gjendjen, e sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me kontratat dhe specifikimet, ose të merren masat te ata që kanë mundur të shkelin ligjin. Mos shpalosja e saktë e informacioneve është një e metë e të gjitha OB, por besoj që në vitin 2011 kjo do të jetë më ndryshe “ më saktë”.

Adem Grabovci – Nga raporti i ZAP rezulton se në këtë ministri ka të gjetura të shumta, por duhet të merret për bazë fakti se është fjala për raportin e vitit 2010, e që nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me ministrin aktual. Kërkoj që të evitohen këto lëshime dhe shprehu gadishmërin për bashkëpunim me Komisionin që këto të gjetura të tejkalohen. Pyeti:sa ka arritur të

përmirësohet gjendja në këtë ministri dhe sa është arritur në adresonimin rekomandimeve të ZAP-it.

Armend Zemaj – Është për tu shqetësuar fakti që është numër i vogël i raporteve që kanë opinion të pakualifikuar, sepse kjo do të siguronte Komisionin se ka një trajtim serioz të menaxhimit të financave publike. Nga raporti shihet se problematika kryesore në MD ka qenë organizimi i brendshëm, sidomos të përgjegjësia ekzekutive duke filluar nga ZKA i cili ka pasur tri funksione. Lidhur me këtë kërkoi sqarime nga ministri.

Çështjet e prokurimit - si duket çështja e kriterëve të tenderëve po merren për mostra nga auditorët ku nuk po mund të përmbushen kriteret dhe ka të gjetura që janë ndoshta si pasojë e nivelit të OE dhe gjendjes në përgjithësi në vendin tonë. Komisionit i intereson për përgjegjësinë administrative ndaj njerëzve që kanë keqpërdorur paranë publike, apo edhe që e keq menaxhojnë atë. Kjo duhet bërë, sepse duhet të ndërpritet ky trend negativ i menaxhimit të parasë publike.

Hajredin Kuqi – Në MD ka edhe më shumë parregullsi, se sa që janë konstatuar nga ZAP-i. Raport ka të bëjë periudhën 2010, përfshirë këtu edhe periudhën pa ministra dhe zëvendësministra. Me stafin aktual garantoj që do të përmirësohet gjendja, por jo ndoshta ashtu si duam, por për këtë duhet të ndihmoj edhe Komisioni. Metodat që janë ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes janë: ndërtimi i objekteve kapitale është hequr nga MD. Komisioni duhet të ftoj të gjithë ministrat me përjashtim të MAP për të bërë një gjë të tillë. MD nuk punon ndërtesa, ajo merret me ligje. Kanë qenë 70 milion investime kapitale që s'kam pranuar për t'i menaxhuar. Janë bartur kompetenca të plota në prokurori për: administratë, prokurim dhe financa. Janë bartur kompetenca të plota në shërbimin korrektues për prokurim financa, administratë dhe personel dhe tani më MD nuk përzihet në këto gjëra. Shkeljet që janë përmendur në raportin e ZAP, janë ngritur në prokurori: çështja e kontratave të tejkaluara, çështja e pagesave jashtë kontratave dhe me çështje të tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e keq të çështjeve. MD ka një plan veprimi të cilin e ka dorëzuar në ZAP dhe në këtë mbledhje edhe në Komision. Departamenti për qasje në drejtësi, trafikim me qenie njerëzore dhuna në familje, integritet gjyqësor janë bartur në kompetenca ku edhe duhet të jenë si prokurori, këshilli gjyqësor etj. Është bërë rishikimi sipas rekomandimeve të FREEDOM –it për të gjithë ministrinë. Në këtë vend në emër të pavarësisë, ka mungesë të llogaridhënies. Janë suspenduar njerëz të prokurimit, kjo me kërkesën që i është bërë OSHP-së dhe Komisioni duhet ta ndihmoj MD që të gjithë njerëzit e prokurimit në qeveri të ndërrohen Në MD ka 10 vite që kompanitë e njëjta fitojnë tenderët, dhe këto janë tri kompani. Ka ndërmarrë hapa konkret në reduktimin e shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile. Pa shërbimin korrektues janë 340 të punësuar në MD. Dhe me 100 të punësuar puna kryhet si duhet në këtë ministri. Nuk është pranuar asnjë gardian në punë. Sipas tremeve evropiane një gardian parashihet për dy të burgosur. Në Kosovë është e kundërta. Janë 1000 të punësuar që nuk i duhen askujt. GPS janë vendosur në gjitha veturat e Ministrisë. Asnjë këshilltar i ministrit tani nuk përdorë veturën, këtë e bënë vetëm ministri, atë për nevoja zyrtare. Në këtë ministri kanë qenë mbi 300 vetura në dispozicion 24orë, kjo tani më ka ndryshuar. Është kërkuar që të zvogëlohet numri i veturave dhe kjo është bërë përmes ankandit publik. Është hequr pjesa e buxhetit që ka të bëjë me veturat. Janë rregulluar kamerat në burgun e Dubravës për perimetrin e jashtëm dhe janë hequr të gjitha shpenzimet që bëhen lidhur me veturat. Është bërë reduktimi i udhëtimeve jashtë vendit. Tashmë asnjë udhëtim jashtë vendit nuk mund të bëhet pa ftesë në emër të ministrisë. Asnjë seminar me buxhetin e MD nuk bëhet jashtë Kosovës. Buxheti i Kosovës duhet të shpenzohet në Kosovë. Është bërë reduktimi i pagave për punën jashtë orarit. Në MD më nuk paguhen honorare brenda Kosovës. Në këtë ministri janë paguar njerëz me honorar për punët e veta personale. Tashmë asnjë individ nuk mund të avancohet pa kriteret dhe pa konkurs publik. Ka probleme më njerëzit të cilët punojnë në këtë ministri, dhe këto probleme nuk janë politike. Por, probleme me dinamikën e punës dhe me ligjin, në pajtim me të cilin duhet të jenë ata njerëz.

Përveç shtatë rekomandimeve të dala nga ZAP, janë ndërmarrë edhe 70 masa të tjera. Është

formuar Komisioni për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë. MD nga 22 shkurti në faqen e internetit çdo të premte në ora 16 publikon shpenzimet përfshirë edhe shpenzimet e ministrit. Kjo për hir të transparencës në këtë ministri. Është turp që të gjeturat e ZAP të jenë në këtë ministri. I është dërguar letër z.Mustafa, z.Kurti dhe z.Shala dhe organizatave joqeveritare që të dërgojnë njerëz në monitorim të procedurave të prokurimit në këtë ministri. OJQ-të janë prezentë dhe kanë qasje të plotë dhe kanë qasje 24 orë në burgje.

Asnjë tenderim në MD tani nuk bëhet pa mbikëqyrjen vendore dhe ndërkombëtare. I është dërguar letër EULEKS-it që të vijnë të mbikëqyrin panelin për lirim me kusht dhe të mbikëqyrin dhënien e provimit të jurisprudence dhe të noterisë. Është respektuar çdo vendim të KPMK-së. Por, duhet të ju njoftoj se KPMK-ja nuk ka njeri që nuk është duke e kthyer në punë në këtë vend. Lidhur me këtë duhet të veproj Kuvendi. Ka raste kur personi ka procedurë në gjykatë, KPMK-ja të njëjtin person e kthen në punë. Në raste të tilla po legalizoj një vendim të paligjshëm të dikujt tjetër. KPMK-ja është bërë super-gjykatë. Fatkeqësisht Kuvendi i ka mbështetur dhe zgjedhë ata njerëz.

Janë trajnuar stafi për programet për menaxhimin e financave, përgatitjen e pasqyrave financiare. Është formuar komisioni për regjistrimin e pasurisë. Para 31 dhjetorit do të jenë të regjistruara. Është kërkuar që për çdo projekt kapital të përcaktohet një menaxher të projektit i cili do të përcjellë në vazhdimësi punën edhe pse projektet kapitale janë reduktuar në këtë ministri, sepse projektet kapitale i kam bartur në ministrinë e administratës Publike. MD bënë politika të drejtësisë dhe ligje, nuk merret me investime kapitale. Është rekrutuar certifikues për shërbimin korrektues të Kosovës.

Jam ndërmarr masa për të veprimet e dhena nga auditori në vitin 2009, sepse në vitin 2010 gati 6 muaj ka qenë ministria edhe pa ministër edhe pa zëvendësministër dhe me ushtrues detyre të sekretarit. Kompensimi i komisionit vlerësues për provim të jurisprudence dhe noterisë është bërë tani nga të hyrat e paraqitjes së këtyre provimeve. Dhe janë reduktuar për 50%. Çmimi për provim të jurisprudence nga 150 euro e është zbritur në 50 euro, sikurse anëtarët e Komisionit vlerësues nga ka nevojë të paguhet ashtu siç janë paguar deri më tani (anëtarët e Komisionit janë paguar sa të drejtë ministri). Nuk është ndërruar asnjë anëtar i Komisionit, kjo me qëllimin për të mos dhënë perceptim politik partiak, por një gjë duhet thënë se ka anëtar të Komisionit që nuk e meritojnë të jenë nëpër Komisione vlerësuese – kjo në kuptimin profesional. MD është në përfundim të një udhëzuesi të brendshëm për propozimet e dala dhe analizat e mundësive të këtij raporti dhe nga 1 janari do të implementohet. Në vitin 2010 raporti do të jetë në përputhje me udhëzimin e brendshëm. Do të ketë adresim, është kërkuar që të ketë adresim të përgjegjësisë individuale dhe përgjegjësi për ministrinë. Problemet janë më të mëdha me panelet sesa me të përzgjedhurit. Sepse, panelet të sjellin para aktit të kryer dhe çdo veprim i kundërt me atë të panelit, pastaj del si veprim kundërligjor, por në anën tjetër ke produktin me të cilin nuk pajtohesh. Panelet duhet të jenë më profesionale dhe ftoi Kuvendin që të jenë mbikëqyrës edhe në panele.

MD ka Komitetin e auditimit i cili funksionon dhe mban takime. Por, duhet të ndërrohet qasja për auditorët e brendshëm, sepse auditori i brendshëm duhet të jetë i pavarur prej ministrive. Auditimi i brendshëm aktualisht është pjesë e veprimeve që bëhen në ministri. Pra, duhet të shikohet Ligji për auditim të brendshëm, në mënyrë që edhe vet ministrit të kenë një kontroll të pavarur. Është themeluar edhe inspektorati i shërbimit korrektues të Kosovës, i cili po bënë kontrollin e punës të ligjshmërisë brenda këtij shërbimi. Kërkoj ndihmën e Kuvendit në perceptim për veprimet që duhet ndërmarr.

Adem Grabovci – Këtë që tha ministri do të duhej ti dëgjonin edhe shumë përfaqësues të institucioneve të tjera, sepse të gjeturat nuk janë vetëm në këtë ministri. Ministri shumë guximshëm ngriti fenomenet e përgjithshme, pa u lëshuar në faktin e në cilën periudhë kohore kanë ndodhur ato. Komisioni do të angazhohet që edhe nga OB-të e tjera të kërkoj prej tyre të ngritin shqetësimet e tyre që të hapet një luftë pa kompromis në luftimin e këtyre fenomeneve. Kuvendi ka përgjegjësinë më të madhe që të ndihmoj ekzekutivin në luftimin e këtyre fenomeneve. Është fakt se nëse ndërmerr një masë, mediat do të kesh në shpinë kjo duhet të ngrihet në Kuvend. Të akuzuarit duhet të shkojnë në përgjegjësi.

Murselj Haljilji- Tha se ministri aktual në MD e njeh mire situatën në ministri dhe mënyrën se si ti zgjedh këto probleme. Kjo është gjë pozitive. Raporti i kësaj ministrie flet shumë më shumë nga ajo që është marrë nga ZAP-i. Janë potencuar shumë pyetje dhe në këtë drejtim ministri ka ide se si t'i zgjidh këto probleme. Komisioni duhet ta përkrah ministrin për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Armend Zemaj – Tha se kjo ministri duhet të jetë shembull edhe për ministrinë e tjera. Këtë vizion të ministrit dhe këto veprime konkrete dëshiroj të barten edhe në ministrinë e tjera. Niveli i bashkëpunimit nuk do të mungoj.

Valbona Dibra –Sqarimet e ministrit ishin shumë bindëse dhe siguroj ministrin se do ta ketë përkrahjen e Komisionit në çfarëdo aspekti lidhur me punën në MD. Falënderoj ministrin për sqarimet dhënë këtij Komisionit.

Albert Kinolli – Raporti i ZAP është shqetësues, por ministri aktual nuk është përgjegjës për problemet e akumuluar. Përgëzoj ministrin për masat e ndërmarra. Ky është shembull se si duhet të punojnë edhe ministrat e tjerë, të cilët i ikin përgjegjësisë dhe nuk përballen me të gjeturat e ZAP-it.

Kryetari – Përgëzoi ministrin për veprimet e ndërmarra, por tërhoqi vëmendjen se duhet pritur raportin e radhës të auditimit të kësaj ministrie, për të parë përmbushjen e këtyre veprimeve.

Lars Lage OLOFSSON – Fjalimi i ministrit është shumë premtues dhe ministri është në dijeni se situata aktuale është shuam sfiduese. Ka gjëra që nuk janë në zbatim dhe kjo sigurisht u reflektua edhe në dialogun në këtë mbledhje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

- 1. Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010, nuk procedohet për në mbledhje plenare.*
- 2. Mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve, Komisioni do ta bëjë me raportin e radhës të auditimit nga ZAP-i.*

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010

Kryetari konstatoi se, ministri i MPMS ka prezantuar në mbledhje, mirëpo për shkak të zgjatjes së shqyrtimit të Raportit të MD, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010, shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Në rastet kur në rend dite janë dy e me tepër raporte për shqyrtim, ftesa për pjesëmarrje në mbledhje të përfaqësuesve të OB, të jetë jo në orare të njëjta, por duke marrë për bazë kohën sa merr shqyrtimi i një raporti.

5. Të Ndryshme

a). Diskutim rreth shqyrtimit të raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit me këshillën ligjore të përgatitur nga Administrata e Kuvendit, përkatësisht Departamenti Ligjor i Kuvendit. Sipas së cilës para Komisionit është llogaridhënës për shpenzimin buxhetit është sekretari permanent i Gjykatës.

Po ashtu Gjykata Kushtetuese ka dhënë përgjigje se kërkesa e Komisionit për të ftuar në mbledhje kryetarin e Gjykatës Kushtetuese është kundër Kushtetues, duke mos u bazuar në asnjë nen. Në mbledhjen e kaluar sekretari i Gjykatës i është referuar Ligjit për protokollin e shtetit, por ai është Ligji për protokollin jo për çështjet e raportimit.

Theksoi se ai personalisht gjithmonë ka qenë kundër që i pari i institucionit të mos jetë gjithmonë i ftuar në mbledhjen e Komisionit, por kjo me vendim të Komisionit nuk është përkrahur dhe është vendosur që në mbledhje të Komisionit të prezantoj përfaqësuesi më i lartë i Komisionit.

Ramiz Lladrovci – Komisioni nuk ka nevojë për dokumente që tregojnë se çfarë detyra ka Komisioni për buxhet dhe financa. Komisionit i intereson se cila është përgjegjësia e Gjykatës Kushtetuese para këtij Komisioni. Komisioni nuk po cenon pavarësinë e gjykatës, por ky Komision është përgjegjës për të mbikëqyrur shpenzimin e buxhetit të ndarë për këtë gjykatë dhe përgjegjës para këtij Komisioni lidhur me këtë është kryetari i Gjykatës. Edhe sipas këshillës ligjore të shërbimit ligjor të Kuvendit askund nuk thuhet që Komisioni nuk ka të drejtë të ftoj kryetarin e Gjykatës në mbledhje të Komisionit. Rekomandimet i drejtohen menaxherit kryesor të OB, në rastin konkret kryetarit të Gjykatës, sepse sekretari nuk ka respektuar standardet për menaxhim të mjeteve. Komisioni e ka ftuar kryetarin në cilësinë e menaxherit kryesor. Kryetari i Gjykatës ka përgjegjësi për nënshkrimin e tenderëve me vlerë të madhe dhe ai është përgjegjës për atë. Ndërsa, për sekretarin e dimë që është përgjegjës i administrativ.

Armend Zemaj – Dokumenti nga administrata përkatësisht zyra e sekretarit ka dhënë vetëm një përshkrim të ligjeve dhe nuk është ajo çka ka kërkuar Komisioni. Kjo për faktin se për përfaqësim i është referuar Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe këtu është gabimi. Sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, gjykatën e përfaqëson kryetari i Gjykatës neni 11, pastaj neni 12 i Rregullores së Gjykatës Kushtetuese thotë që kryetari i gjykatës përfaqëson gjykatën dhe vendos bashkëpunim me institucione të tjera dhe autoritetet publike, rregulli 15 përcakton se sekretari administrativ i gjykatës ka përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve administrative dhe jo përgjegjësi politike para Kuvendit. Pra interpretimi që ka bërë administrata përkatësisht Departamenti ligjor është në kundërshtim me ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat e brendshme. Kryetari i Gjykatës mund të kërkojë mirëkuptim nga Komisioni se për shkak të angazhimeve nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, por jo ti referohet Ligjit për protokollin që nuk mundet t'i raportoj KMFP.

Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm – Tha se është parim që gjithmonë duhet të jetë dikush të cilit duhet kërkuar llogari për mënyrën e si shpenzohet buxheti, pastaj për auditorin e përgjithshëm kur lexohet Ligji i Gjykatës Kushtetuese, personi që është përgjegjës dhe që duhet kërkuar llogari është kryetari i Gjykatës. Ai nënshkruan raportet dhe ai është

përgjegjës. Por, nuk ishte i sigurt nëse presidenti është përgjegjës. Dhe nëse ai është person përgjegjës, ai duhet të vij para Komisionit. Pra, nuk është pyetja nëse ai është përgjegjës ose jo, sepse faktikisht ai është përgjegjës. Është e qartë puna e gjykatës dhe veprimtarisë, por kur vije pyetja se si e ka trajtuar buxhetin duhet të vij para Komisionit.

Murselj Haljilji – Kryetari i Gjykatës Kushtetuese është përgjegjës edhe kur nuk është i pranishëm në mbledhje. Domethënë përgjegjësia e tij nuk duhet lidhur me praninë ose jo të tij në mbledhje të Komisionit. Komisioni duhet të punoj, është marrë mendimi i Administratës, pastaj duhet prituri edhe mendimi i auditorit të përgjithshëm dhe nëse Komisioni prapë ka dilema atëherë ka institucione të cilat merren me këtë. E rëndësishme është që Komisioni të mos gabo, sepse nëse Komisioni merret me atë se cili mendim është më i mirë për vesh, atëherë në këtë mënyrë nuk do të zgjidhet problemi.

Valbona Dibra – Ishte e mendimit se kryetari i Gjykatës Kushtetuese duhet të përgjigjet para këtij Komisioni për shpenzimet buxhetore. Buxhetin e ka marrë nga Kuvendi dhe duhet të vijë në këtë Komision për shpenzimet e bëra. Domethënë, para Komisionit duhet të përgjigjet për shpenzimin e parasë publike jo për punë të tjera të Gjykatës.

Albert Kinolli - Komisioni ka marrë vendim se kush duhet të prezantoj para tij dhe nuk duhet lejuar që të punohet në dy drejtime. I pari i institucionit duhet të ftohet në mbledhje të Komisionit. Nëse e ndryshojmë vendimin e Komisionit atëherë i bie që institucionet e caktuara marrin vendime për këtë Komision.

Kryetari konstatoi se në mbledhjen e Komisionit të pranishëm ishin 7 deputet dhe me 5 vota për një kundër dhe një abstenim, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nxori këtë

Përfundim

Shqyrtimi i raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës bëhet në mbledhjen e Komisionit, pa praninë e kryetarit të Gjykatës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu